



KESHILLI I BASHKISE KORÇE

VENDIM

Nr. 29 Datë 14.04.2010

MBI PERCAKTIMIN E ORAREVE TE KTHIMIT TE LINJAVE TE RREGULLTA NDERQYTETESE NE TRANSPORTIN E UDHETAREVE ME AUTOBUSE

Keshilli i Bashkise Korçe ne mbledhjen e tij te dates se sotme pasi morri ne shqyrtim kerkesen e subjekteve te transportit te qytetit te Korçes "Start Bus Korça" sh.p.k dhe "Morava 93" sh.p.k, si dhe ne informacionin e paraqitur nga Drejtoria e Kontrollit te Territorit " Mbi oraret e autobuseve te cilet operojne ne linja nderqytetese", me propozim te Komisionit te Sherbimeve te Keshillit Bashkiak, bazuar ne ligjin nr 8652, date 31.07.2000 " Per organizimin dhe funksionimin e Qeverisjes Vendore", neni 32, pika k ;

VENDOSI :

1. Oraret e kthimit te autobuseve te linjave nderqytetese me destinacion qytetin e Korçes te jene pas ores 11.00.
2. Per zbatimin e ketij vendimi ngarkohet Drejtoria e Kontrollit te Territorit dhe Drejtoria e Policise Bashkiake.
3. Cdo vendim i meparshem i cili bie ne kundërshtim me kete vendim shfuqizohet.
4. Ky vendim hyn ne fuqi menjehere.

KRYETARI I KESHILLIT BASHKIAK
Gjergji PENDAVINJI